

Hasan KALESHI

IDETË PËRPARIMTARE TË DISA IDEOLOGËVE TË LËVIZJES SË NACIONALIZMËS SHQIPTARE NË GJYSMËN E DYTË TË SHEKULLIT XIX NË BASHKËPUNIM ME POPUJT E BALLKANIT

Një ndër problemet elementare të historisë bashkëkohore të popullit shqiptarë është çështja se kur ka filluar lëvizja nacionale shqiptare, cilat janë karakteristika elementare, cila është baza ideologjike, kush janë bartësit dhe propaganduesit e saj, deri në çfarë mase idetë e tyre kanë depërtuar në masën e gjerë të popullit shqiptarë, cilat kanë qenë raportet e kësaj lëvizje me lëvizjet tjera të popujve të Ballkanit, etj.

Çështja është shumë komplekse dhe e ndërlikuar, sepse kushtet dhe rrethanat në të cilat ka lindur lëvizja nacionaliste shqiptare, janë gjithashtu të ndërlikuara dhe specifike. Ato ndryshojnë në shumëçka me kushtet në të cilat kanë lindur lëvizjet nacionaliste të popujve tjerë të Ballkanit. Para se gjithash, në krahasim me popujt tjerë të Ballkanit, këtu kemi parasysh pjesëtarët e tri besimeve fetare, shqiptarët kanë qenë më së shumti të inkorporuar në administratën turke dhe në udhëheqjen ushtarake.¹ Në periudhën e zgjimit nacional, gjatë gjysmës së dytë të

¹ Zakonisht thuhet se vetëm shqiptarët myslimanë kanë marrë pjesë në betejat të ndryshme bashkë me turqit. Mirëpo, ortodoksët toskë janë konsideruar mercenarët më të mirë të Turqisë. Ata kanë marrë pjesë në shtypjen e kryengritjes për tridhjetë vjet me radhë të shekullit XIX, saqë kanë marrë pjesë edhe në shuarjen e kryengritjeve të shqiptarëve gjatë viteve 1910-1912. Katolikët e Shqipërisë veriore, të organizuar në bajraqe, rregullisht kanë marrë pjesë në luftërat kundër Greqisë dhe kundër Malit të Zi. Një seri të dhëna hasim në raportet e Xhevdet pashës (Tezâkir -ed. Baysun). Jasha Tomiq ka shënuar një bisedë tejet interesante me Sokol Bacën, një hero i njohur në kryengritjet e shqiptarëve katolik kundër Turqisë gjatë vitit 1912. Kur Jasha

shekullit XIX, pjesëtarët e të tri konfesioneve fetare kanë pasur aspirata të ndryshme, apo edhe të kundërta. Ata shpeshherë ishin nën presionin e jashtëm politik dhe kulturor nga anë të ndryshme nga jashtë. Në mesin e ortodoksëve të jugut të Shqipërisë ishte tejet e fuqishme propaganda greke, e cila funksiononte e organizuar nëpërmjet kishës në krye me patrikanën e Stambollit. Ai presion nuk ishte vetëm nga aspekti fetar dhe politik, por kishte edhe presion kulturor si dhe në fushën e arsimit. Kjo propagandë ka pasur mjaft ndikim te popullata shqiptare e besimit ortodoks, edhe pse sot ai ndikim tentohet të minimizohet.² Në Shqipërinë veriore, në mesin e popullatës së besimit katolik ishte tejet e fuqishme propaganda austro-hungareze, e cila kishte mbështetje të fortë te kleri katolik, sidomos te françeskanët,³ si dhe te një pjesë e parisë shqiptare, si te bejlerët dhe te intelektualët myslimanë, të cilit kishin nuhatur fundin e shembjes së Turqisë, andaj edhe kërkonin mbështetje tek Austro-Hungaria. Nga ana tjetër, e ashtuquajtura çështja e Adriatikut ishte preteksti kryesor i Italisë që të ndërhynte në çështjet shqiptare dhe të shtrinte ndikimin, e që për mbështetje kryesore kishte

Tomiq e ka anketuar atë rreth Turqisë, ai është përgjigjur: “Turqit kurrë nuk kanë kërkuar nga ne haraç, nuk kanë kërkuar ushtri, por në luftë ka shkuar ai që ka shprehë dëshirë. Atëherë kemi pasur komandantët tonë, bajraktarët tanë dhe gjithçka tonën. Kemi pasur edhe gjykatat tona të eprorëve, të cilët kanë gjykuar, jo sipas ligjeve turke, por sipas kanunit të Lek Dukagjinit. Edhe atëherë kur kanë marrë tati me, kanë marrë vetëm në afërsi të qyteteve. Kanë marrë të njëzetat e më pak, e jo të dhjetat, vetëm sa për thënë se po vjelin tatim. Tani, para disa viteve, turqit kanë dashur të na marrin në ushtri dhe të na marrin armët dhe ne rregullisht të paguajmë një të dhjetat.” Jasha Tomiq, Rat u Albaniji i nad Skadrom 1912 godine, Novi Sad 1913, 14).

² Si shkak i kësaj propagande dhe një mori masa politike-administrative, shqiptarët e besimit ortodoks-grek, në viset të cilat iu ishin bashkëngjitur Greqisë, tërësisht janë asimiluar në grekë, kurse myslimanët, shqiptarët dhe turqit, që nuk janë asimiluar, fizikisht janë shfarosur apo janë zëvendësuar me grekë nga Turqia pas revolucionit të Kemalit.

³ Françeskanët që në shekullin XV, nëpërmjet Bosnjës kishin filluar të depërtonin në Shqipëri. Nga shekulli XVII edhe më tepër kishin raporte me Austrinë. Numri më i madh i françeskanëve shkollohej në kolegjet në Salzburg, Insbruk dhe në shkollat e mësuesisë në Klagenfurt dhe në Vering afër Vjenës.

te një pjesë e klerit katolik shqiptarë (jezuitët),⁴ si dhe te shoqatat shqiptare në Itali. Ky ishte shkaku kryesor që prej gjysmës së dytë të shekullit XIX, e deri në përfundim të Luftës së Parë Botërore, zhvillohej një luftë e fshehtë mes Italisë dhe Austro-Hungarisë rreth shtrirjes së ndikimit në veri të Shqipërisë.⁵ Edhe Austro-Hungaria edhe Italia, zhvillonin një propagandë kulturore duke hapur shkolla, të cilat i financonin vetë ato, duke botuar vepra, botimin e gazetave dhe revistave, duke themeluar dhe financuar shoqata të ndryshme si dhe duke shkolluar nxënës shqiptarë nëpër shkollat e tyre. Edhe pjesa myslimane e popullatës shqiptare në aspektin e besimit, në atë politik, kulturor, e deri diku edhe social, ishte e orientuar kah Turqia dhe kah kultura orientale. Kjo lidhje e popullatës myslimane me Turqinë më tepër është shprehur pas formimit të Malit të Zi, Serbisë dhe Greqisë, e më vonë edhe të Bullgarisë, të cilat haptas kishin pretendime territoriale karshi trojeve me shumicë shqiptare. Ata ishin bindur se me shembjen e Perandorisë Osmane, shtetet ballkanike do të sundonin me këto troje.⁶

⁴ Jezuitët aktivitetin e tyre në Shqipëri e kanë filluar në mesin e shekullit XIX, me ndihmën financiare të Vjenës. Ata ishin nën ndikim të Romës. Shtrirja e ndikimit të Italisë i ka shërbyer dy institucioneve të larta shkollë: kolegjit italian-shqiptarë të Shën Adrianit në S. Demetrio Corone, i themeluar në vitin 1733, me përkrahjen e Klementit II, i cili për qëllim kishte krijimin e kuadrit fetar shqiptar dhe katedrat shqiptare në "Istituto orientale" në Naopoli, i hapur në vitin shkollor 1900/01. Përveç kësaj Austro-Hungaria dhe Italia, në fillim të këtij viti kanë pasur një varg shkolla në Shqipëri dhe në Kosovë, e që vetë ato i financonin.

⁵ Për më tepër shih: Hans Dieter Scjandel, Die Alabanienspolitik Österreich-Ungarns und Italiens 1877-1908, Otto Horrosswitz, Weisbade, 1971, Albanische Forschungen 9).

⁶ Administrata turke ka bërë gjithçka për të penguar ngjalljen e ndjenjave nacionale të shqiptarëve. Kjo ishte më se normale, sepse kjo do të shpinte deri te tendencat për autonomi dhe për shkëputje nga Perandoria Osmane. Por duhet të kemi parasysh se baza ideologjike e Perandorisë ka qenë e ndërtuar në themele fetare, nuk kanë ekzistuar dallimet në baza nacionale, dallimet kanë qenë vetëm në baza fetare. Mu për këtë, te shumica e popullatës shqiptare myslimane, ndjenja fetare ka mbisunduar në atë nacionale. Mjafton të përmendet rasti i revoltës së fshatarësisë myslimane më 1913-1915, në krye të së cilës ka qenë kleri mysliman. Kryengritësit kishin marrë nën kontroll tërë Shqipërinë, përveç Shkodrës, dhe e detyruan Princ Vidin të krishterë të largohet nga Shqipëria. Ata gjithandej kishin hequr flamurin shqiptarë dhe kishin vendosur flamurin me gjysmë hënë dhe kërkonin që Shqipëria të kthehet

Megjithatë duhet të kemi parasysh, se shqiptarët deri në kohën e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) deri në një masë kanë jetuar të izoluar karshi Evropës, dhe nuk kanë komunikuar me botën tjetër. Idetë politike dhe kulturore evropiane shumë vonë kanë filluar të depërtojnë në mesin e shqiptarëve. Vetëdija politike shqiptare shfaqet në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në mesin e intelektualëve jashtë Shqipërisë. Jeta patriarkale, organizimi fisnor në pjesët veriore, autonomia fisnore të cilat për gjatë kohë kanë qenë të konservuara në mesin e shqiptarëve, e që shqiptarët me fanatizëm i kanë ruajtur gjatë përpjekjeve të turqve që të aplikojnë një sistem ligjor të ri dhe një administratë të re pas Tanzimatit,⁷ marrëdhëniet çifligare dhe pronarët e vegjël të tokave tejet të zhvilluara në Shqipërinë e Mesme dhe atë të Jugut, e që flet për një strukturë sociale dhe ekonomi mjaft heterogjene, mungesa e një organizate politike unike me program politik të përpunuar, mungesa e një unifikimi politik, kulturor dhe ekonomik, mungesa e një shtrese qytetarie, e cila do ta bartte barrën e transformimit shoqëror dhe ekonomik të marrëdhënieve ekzistuese feudale të unifikimit dhe të qëndrojnë ballë lëvizjes për çlirim kombëtar,⁸ gjithë këta kanë qenë faktorë që nuk kanë lejuar për një zgjim të hovshëm të vetëdijes nacionale. Shqiptarët nuk kanë pasur vazhdimësi të kulturës së tyre, nuk kanë pasur kisha të veta, të cilat do të kishin vazhduar traditën e më hershme në shkollim dhe arsimim dhe t'i trimërojnë popullin për çlirim sa më të

nën mbikëqyrjen e Sulltanit, apo në krye të Shqipërisë të jetë një princ turk. Pikërisht, bazuar në këto shkaqe parulla kryesore e lëvizje iluministe shqiptare në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX ndjenja nacionale ka qëndruar mbi përkatësinë fetare.

⁷ Për më tepër shih: *Hasan Kaleshi, Турски покушаји ревидирања законика Леке Дукађина и укидање аутономије албански племена у XX веку*, “Обичајно право и самоуправа на Балкану и суседним землама”, Балканолошки институт, Београд, 1974, 389’410.

⁸ Si ilustrim, do të përmendim se tregtia më e madhe në Kosovë gjatë shekullit XIX dhe shekullit XX ka qenë në duart e serbëve, çifutëve dhe vllahëve. Në Shqipërinë jugore dhe atë të mesme, pjesa kryesore e tregtisë ka qenë në duart të grekëve dhe vllahëve. Vetëm në Shkodër borgjezia tregtare shqiptare ka qenë më e fuqishme.

shpejtë, ashtu siç ka qenë rasti me kishën greke dhe atë serbe, nuk kanë pasur klerin e tyre, ata kishin klerin e huaj, në shërbim të të huajve, në pamundësi që të kuptohet me popullatën, e që ka qenë një ndër faktorët kryesor në islamizimin e shpejtë dhe masiv të shqiptarëve. Edhe shkollat ekzistuese të gjysmës së dytë shekullit XIX në gjuhën turke, greke, italiane apo në gjuhën shqipe, të cilat i ka mirëmbajtur kisha greke, Italia dhe Austro-Hungaria, më shumë kanë ndikuar në përçarjen nacionale sesa në bashkimin nacional. Deri në vitin 1908 shqiptarët nuk kanë pasur alfabet të unifikuar. Veprat e shekullit XVI kanë qenë të shkruara me alfabet grek, latin apo me alfabet arab, varësisht përkatësisë fetare të autorit dhe ambientit fetar-kulturor në të cilin kanë lindur ato vepra, mu për atë, deri në gjysmën e dytë të shekullit të XIX, nuk mund të flitet për një letërsi të bashkuar nacionale. Kjo duket edhe më e pakuptimtë kur dihet se shqiptarët atëkohë kanë pasur një numër të madh të politikanëve të rangjeve më të mëdha dhe një ekip intelektualësh, të cilët nuk kanë qenë mbrapa karshi popujve tjerë të Ballkanit, por që kanë qenë në shërbim të Turqisë, kanë shkruar në gjuhët orientale, pa një lidhje të fortë me popullin e vetë, kanë shërbyer në skaje të ndryshme të Perandorisë Osmane.⁹ Mu për atë, lufta e shqiptarëve kundër pushtetit turk në gjysmën e parë të shekullit të XIX e deri në kohën e Lidhjes së Prizrenit, medoemos duhet kuptuar si shprehje për të ruajtur interesin regional dhe autonominë fisnore, si luftë kundër heqjes së një numri të privilegjeve, të cilat i kanë pasur për shekuj me radhë, e që pas Tanzimatit, Turqia insistonte t'ua merrte ato privilegje. Gjithashtu duhet kuptuar si luftë të feudalëve dhe ajanëve, të cilëve u

⁹ Për shembull të cekim Ferid Pashën e Vlorës, i cili në vitin 1906 ka qenë kryeministër; Abedin Pasha vali në disa vilajete dhe ministër gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit, autor i disa veprave në arabisht, persisht, turqisht dhe greqisht; Vaso Pasha vali i Libanit; Ismail Kemali ka qenë vali, këshilltar i sulltanit dhe bashkëpunëtori më i madh i Mit'hat Pashës; Sami Frashri leksikografi dhe enciklopedisti më i madh turk, Hoxha Tahsini rektori i parë i Universitetit të Stambollit dhe shumë personalitete të tjera. Mund të radhisim edhe dhjetëra emra të tjerë, të cilët në fund të shekullit XIX kanë luajtur rol të rëndësishëm në administratën e Perandorisë Osmane si dhe në jetën kulturore.

shkonte për shtati anarkia feudale, sepse duke e mbajtur pushtetin në duart e tyre, kishin mundësi të bënin keqpërdorime të llojllojshme, e sidomos karshi rajës dhe në këtë mënyrë të pasuroheshin, e kurrsesi si shprehje e vetëdijes nacionale shqiptare, ashtu siç tentohet të paraqitet.¹⁰

Si argument kryesor dhe gati të vetëm, rreth ekzistimit të vetëdijes nacionale dhe të lëvizjes për emancipim kulturor dhe arsimor, përmendet emri i Naum Veqilharxhit, i cili në vitet e dyzeta të shekullit të kaluar, bashkë me mësuesin bullgar Ivan Seliminski kishin shkruar një manifest në gjuhën greke, duke ua drejtuar shqiptarëve të besimit ortodoks-grek. Për këtë manifest thuhet së është “dokumenti i parë programor i lëvizjes kombëtare, për të cilin dimë deri më sot që buron nga ana e intelektualëve shqiptarë. Ai është argument ia asaj lëvizje të re me përmbajtje nacionale, e cila është zhvilluar në të gjitha fushat në Shqipëri, e që ka marrë emrin Rilindje.”¹¹

Mirëpo, në këto rrethana, ky manifest, deri diku mund të interpretohet në mënyra të ndryshme dhe nuk duhet harruar se është shkruar në greqisht, e që do të thotë se atë manifest ka mund ta lexojë dhe ta kuptojë vetëm kleri ortodoks, e që ai kler ka qenë kryesisht grek apo grekomanët apo ndoshta edhe disa tregtar ortodoks, e që do të thotë se ai manifest u është dedikuar vetëm shqiptarëve ortodoks që kanë qenë ndjekës të kishës ortodokse greke, dhe mu për atë ai manifest nuk ia ka

¹⁰ Qëndrimi ynë deri në një masë përputhet me qëndrimin e Klaus Langeas dhe Christine Körenr, të prezantuar në punimin *Di Geselleschaftder Kreshniklieder* (Disertationes Albanice Dr. Rudolf Trofenik, München 1971, 126) ku ndër të tjera thuhet: “Është e pa mundur që një shoqëri të shihet vetëm në këngët kreshnike, kemi edhe atë që ne e quajmë edhe vetëdije kombëtare”. Aktiviteti tepër i madh i shqiptarëve të veriut të Shqipërisë, gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit, medoemos duhet parë si shprehje e interesave regjionale sesa si një vetëdije nacionale të shqiptarëve. Gjithashtu duhet hedhur poshtë edhe mendimin e historiografisë së sotme shqiptare, e cila e sheh si një përpjekje njëshekullore për pavarësi nacionale”. Ne me këtë mendim deri diku nuk pajtohemi, sepse te lidhja shqiptare te një shtresë shohim elemente të vetëdijes kombëtare, por jo edhe te masa e fshatarësisë. Mirëpo elementin nacional, assesi nuk e hasim para Lidhjes së Prizrenit.

¹¹ *Historia e letërsisë shqipe II*, Prishtinë, 1968, 47

dal të dalë jashtë pragut të institucioneve kishtarë të Korçës, e as që mund të bisedohet për ndonjë karakter mbarë shqiptarë që të mund të konsiderohet “manifest kombëtar”. E njëjta mund të thuhet edhe për “Këngët e Milosaut” e shkrimtarit De Rada, e botuar në vitin 1836. Kjo vepër ka mund të ketë pasur një lloj ndikim te shqiptarët e Italisë dhe te disa qarqe intelektuale në Evropë, të cilët kishin treguar interesim për Lindjen dhe Ballkanin, por kurrësi nuk ka qenë e mundur që të kenë ndikim te shqiptarët, të cilët kanë jetuar në Perandorinë Osmane.¹²

Këto janë arsyet që shumë vështirë mund të pranohen qëndrimet e historiografisë zyrtare të Shqipërisë, të cilat i kanë pranuar edhe disa historianë nga Kosova, sipas të cilëve, lëvizja nacionale shqiptare fillon në vitet e tridhjeta të shekullit të kaluar.¹³ Ndryshe nga ata, gjatë shqyrtimit të temës sonë, ne rregullisht do të kemi parasysh Lidhjen e Prizrenit (1878-1881) dhe atë e marrim për fillim të lëvizjes nacionale shqiptare, sepse atëherë për herë të parë paraqitet një lëvizje e orga-

¹² Luigj Gurakuqi, poet, patriot dhe ministër në Qeverinë e Fan Nolit, nxënës i vetë De Radës, ka shkruar se veprat e De Radës kanë mbetur të panjohura në Shqipëri edhe nëpër qarqet intelektuale. Atëherë si ka pasur mundësi të ndikojë në vetëdijen kombëtare të shqiptarëve?

¹³ Historia e popullit shqiptarë II, 21, botim i Prishtinës, dr. Ali Hadri pa asnjë rezervë e pranon këtë mendim në gjitha punimet e tija dhe tani e fut edhe në tekstet e shkollës së mesme. Mjaft karakteristike janë mendimet e dr. Shukri Rahimit, domethënë se një zyrtar i konsullatës serbe në Korçë, i quajtur Aleksandër Iliç, më datë 15 korrik të vitit 1918, ka shkruar një elaborat tejet të mirë, objektiv dhe me kompetence. Elaborati mban titullin: “Aksioni kulturor shqiptarë brenda dhe jashtë vendit”. Ky elaborat ruhet në arkivin e SIP it. Iliç me të drejtë konsideron se Lidhja e Prizrenit ishte fillimi i lëvizjes nacionale shqiptare, por Sh. Rahimi atë e komenton me sa vijon: “Borgjezia zakonisht e komenton se lëvizja nacionale ka filluar me Kongresin e Berlinit, e që historiografia jonë nuk e pranon një konstatim të tillë, sepse lëvizja nacionale shqiptare ka filluar gjatë viteve të tridhjeta të shekullit XX.” Autori (e ai është Aleksandar Iviç, H.K) nuk ka pasur informata për Naum Veqilharxhin dhe Jeronim de Radën në lidhje me afirmimin e gjuhës shqipe që në gjysmën e parë të shekullit XX”. Ne edhe një herë vëmë në pah se atë kohë asnjë shqiptar mysliman, e që ata përbënin 80% të popullatës shqiptare, as që kishte dëgjuar për Naum Veqilharxhin dhe Jeronim de Radën, me përjashtim të atyre që kanë jetuar në diasporë. Gjithashtu, nuk mund të pranojmë konstatim, se borgjezia fiton apo humb nëse thuhet se lëvizja nacionale, të cilën ajo e ka themeluar, ka filluar gjatë viteve tridhjetë, më herët apo më vonë.

nizuar mbarë shqiptare, si në vend ashtu edhe në diasporë, e udhëhequr nga një organizatë mbarë shqiptare, në krye të së cilës ishin përfaqësues të të gjitha shtresave të shoqërisë, e mbështetur nga masa popullore, më tepër në mënyrë instiktive sesa e vetëdijshme.

Atëkohë shtrohen kërkesa të caktuara dhe tepër të qarta për autonomi, atëkohë fillon një rilindje e vërtetë kombëtare, jehona e së cilës në masë të madhe do jetë në literaturë dhe publicistikë. Që nga Lidhja e Prizrenit e këndej do të formoheshin shumë shoqëri shqiptare, të cilat luftonin për një emancipim politik, kulturor dhe arsimor, ajo do të vë në lëvizje shumë gazeta dhe revista në Evropë, në Egjipt dhe në Amerikë, ajo çështjen shqiptare do ta vë para opinionit ndërkombëtarë.¹⁴

Ekziston edhe një faktor tjetër, i cili ka ndikim të madh në lëvizjen nacionale shqiptare, e në veçanti në orientimin e saj, faktor i cili shumë lehtë është anashkaluar. Ai faktor është pavarësia e Serbisë, e Malit të Zi, Greqisë e më vonë edhe e Bullgarisë. Formimi i këtyre shteteve ka shërbyer si shembull për nxitjen e intelektualëve shqiptarë për çlirim. Ky faktor ishte edhe shtytje e popullit shqiptarë, e që ka ushqyer shpresta te intelektualët shqiptarë për çlirim. Në këto kryengritje kanë marrë pjesë edhe shqiptarët, në masë më të vogël krahas kryengritjeve serbe, por në masë më të madhe krahas kryengritjeve të popullit grek. Por, forcimi i këtyre shteteve ka mbjellë frikë tek ata, sepse i gjithë aktiviteti i qarqeve sunduese të këtyre shteteve, platforma e tyre politike, programet e tyre politike, shihnin në ringjalljen e shteteve mesjetare, e që do të thotë pushtimi i trojeve të banuara me shumicë shqiptare. Në të gji-

¹⁴ Kur flitet për shtypin shqiptar, i cili ka nxitur ndjenjën nacionale, ka edhe tepri-me. Harrohet fakti se 90% e popullatës ka qenë analfabete dhe se shtypi nuk ka arritur të depërtojë në Shqipëri. Si argument të këtij konstatimi do të themi se gazeta “Albania”, gazetë e cila botohej në Bruksel, njëra ndër gazetat më të mira të asaj kohe, është financuar dhe shpërndarë nëpërmjet postës dhe shërbimeve konsullate të Austro Hungarisë. Për kundër kësaj, në listën e para pagesve, të cilën e kemi gjetur në arkivin e Vjenës, shihet qartë se në vitin 1900 në Prizren, nëpërmjet konsullatës së Austro Hungarisë, ka arriturvetëm një ekzemplarë. Ai para pages ka qenë mësuesi Mati Logoreci, shërbyes në administratën Austro Hungareze.

tha marrëveshjet, planet, paktet ushtarake të shteteve ballkanike, duke përfshirë edhe idetë për një federatë,¹⁵ shqiptarët nuk merreshin si faktor bashkëpunimi, nuk llogaritej në ta si popull që duhet të kishin shtetin e tyre. Për shembull, marrëveshja serbo-greke e viti 1861, parashihte që nëpërmes Shkumbinit të jetë kufiri mes Serbisë dhe Greqisë. Ata konsideronin se shqiptarët nuk janë të denjë për të bërë një jetë të pavarur, e që do të thotë se ata edhe nuk meritojnë të kenë shtetin të pavarur.¹⁶ Ky ishte edhe qëndrimi i fuqive të mëdha. Shqiptarët konsideroheshin si masë, faktor i rëndësishëm, e sidomos në aspektin ushtarak, i cili mund të shfrytëzohet ose të keqpërdoret në kohë të përshtatshme. I tillë kanë qenë kriteri gjatë përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve në mesin e liderëve. Për shembull, Prenk Bib Dodën dhe Xhelal Pashën, të cilët nuk i fshihnin pretendimet e tyre që të jenë princa dhe mbretër të Shqipërisë, apo vetëm të një krahine, sepse nuk kishin asnjë vizion politik për ardhmërinë e Shqipërisë, i kanë marrë parasysh vetëm interesat e ngushta personale. Për qarqet e atëhershme politike serbe, primare ka qenë që në kohë të caktuar të nxisnin shqiptarët në kryengritje kundër Turqisë, që të krijohet gjendje sa më anarkike, e që në situata të volitshme të pushtonin territoret e banuara me shumicë shqiptare, e që kjo ngjau në vitin 1912.¹⁷ Kur kësaj i shtojmë edhe atë

¹⁵ L. S. Stavrianos, *Ballkan federation. A history of the movement to ward Ballkannity in modern times*. Smith Collexestudies in Histori, vol XXXVII, 1941-1942. 1-4. Northampton (Mass). Një lëvizje revolucionare-socialdemokrate evropiane dhe ballkanike, shqiptarët i njëjthe me të drejta të barabarta me popujt tjerë të Ballkanit në një federatë demokratike ballkanike si “anëtare autonome të federatës demokratike të Ballkanit. Aty Shqipëria do të mund të udhëhiqte një jetë të pavarur”. Kështu qëndronte në manifestin e Kongresit ndërkombëtarë socialist i mbajtur në Bazel, në nëntor të vitit 1912. (Stefanaq Pollo, Mbi disa tipare dalluese themelore të lëvizjes kombëtare shqiptare, Studime Historike 3 Tiranë 1972, 120).

¹⁶ Энциклопедија Југославије I, 156. Në këtë mënyrë Garashanini i shkruan Ristiçiqit 16. III 1876.

¹⁷ Për më tepër rreth kësaj çështje shih: Dragan, Stanjakoviç *Politika serbije prema Albaniji u XIX veku. Prilog poznavanju srbsko-albanski veza prijateljstva u periodu 1844-1875.g.* Zbornik za drustvene nauke MAtice srbske 49, Novi Sad 1968; Vojislav Vukoviç, *Arbanasko jugoslavenski odnosi, Enciklopedija Jugoslavije I,*

se në ballë të lëvizjeve shqiptare qëndronin kryesisht bejlerët, prijës të fiseve dhe intelektualët e familjeve të pasura, të cilët ishin tejet të interesuar për të mbajtur gjendjen të pandryshuar në Ballkan, kurse në anën tjetër Rusia gjithmonë kishte qenë në anën e Malit të Zi, të Bullgarisë dhe të Serbisë, e që u mbillte frikë shqiptarëve, se Italia dhe Austro Hungaria me të gjitha forcat përpiqeshin që të krijojnë ndarje sa më të madhe mes shqiptarëve dhe popujve fqinjë sllav, që politika turke dhe Ballkani në masë të madhe mbështetej në elementin shqiptar, dhe vetvetiu ka qenë e interesuar që në vazhdimësi të mbjell përçarje mes shqiptarëve dhe popujve tjerë të Ballkanit, andaj është e qartë se lëvizja nacionale ka qenë e formësuar si lëvizje anti sllave, por jo edhe anti krishtere. Pse tek ideologët e zgjimit nacional shqiptarë hasim një rrezik karshi fqinjëve, pse mobilizimi i masës fshatare bëhej nën parullën luftë kundër fqinjëve, pse kërkesat e shqiptarëve nuk ishin edhe aq radikale sa i përket Turqisë, pse kërkesat e tyre nuk ishin më të mëdha se për autonomi nën sovranitetin e Sulltanit.

Mirëpo, në rrethanat e tilla aq të vështira ka mjaft shembuj të mirë, të cilët tregojnë se disa intelektualë dhe ideologë të Rilindjes Kombëtare të cilët ardhmërinë e popullit shqiptarë e shihnin në bashkëjetesë me popujt tjerë të Ballkanit. Duhet shtuar se te pjesa dërmuese e tyre, njëjtë sikur te ideologët borgjez të popujve tjerë të Ballkanit, ka ekzistuar ideja e formimit të Shqipërisë së madhe e përbërë prej katër apo e edhe pesë vilajeteve, duke mos pasur parasysh statusin e nacionaliteve të popullatës së atyre vendeve.

Aluzioni i parë i këtyre ideve, bazuar sipas hulumtimeve tona të gjertanishme, është paraqitur te shkrimtarët shqiptarë në Itali, në rend të parë te shkrimtari, poeti dhe publicisti De Rada. Ai ka qenë i inspiruar pjesërisht nga princesha rumune, e cila kishte një prejardhje të hershme shqiptare, Elena Gjika, e cila ka shkruar me pseudonimin Do-

Zagreb 1955, G. Jaksiq i V. Buçković, Spolna politika Srbije za vlade knez Mihaila - Prvi balkanski savez, Beograd 1967. Në varg çështje rreth marrëdhënieve shqiptaro-serbe hasim edhe te disa punime Bl. Stojançević.

ra d'Istria. Në veprën e saj “La naitinalité albanaise”, ajo ka theksuar se shqiptarët gjatë copëtimit të Evropës juglindore, kanë të drejtë të jenë të lirë në shtetin e tyre, bashkë me popujt tjerë të Ballkanit. Shkrimtarët italo-shqiptarë, e në rend të parë De Rada, duke u nisur nga ideja e Dora d'Istria, me të cilën kishte komunikim të rregullt, kanë konsideruar që krizën në Ballkan duhet shfrytëzuar për një kryengritje gjithë shqiptare, e që do të bashkëpunonte në mënyrë të fshehtë me lëvizjet tjera çlirimtare të popujve të Ballkanit. Me këtë grup të shqiptarëve të Italisë, të cilët nuk ishin mjaftueshëm të informuar me rrjedhat në Ballkan, dhe me Dora d'Istrinë, fillon të bashkëpunojë edhe një grup intelektualësh shqiptarë në diasporë, siç është rasti me mbledhësin e njohur të folklorit shqiptarë, Thimi Mitko. Ata entuziazmohen me iluzionet romantike se Shqipëria pasi që të bëhet e pavarur, bashkë me komshin jugor, Greqinë me të cilën e lidhnin interesat e përbashkëta, do të mund të formojnë një federatë, e cila me shtetet tjera të Ballkanit do të përbënin një konfederatë të madhe të Ballkanit.¹⁸ Ide të ngjashme hasim edhe më herët edhe te Naum Veqilharxhi, i cili kishte hartuar një abetare me 32 shkronja, duke marrë për mostër alfabetin sllav, duke vazhduar traditën e shkollës së Elbasanit, e cila në përkthimin e literaturës kishtare në gjuhën shqipe ishte shërbyer me alfabetin unik sllav. Jo vetëm tek ata, por te shumica e intelektualëve të mesit të shekullit të XIX ka ekzistuar një gjykim romantik për origjinë të përbashkët të popullit shqiptarë dhe atij grekë. Atëherë kur intelektualët shqiptarë, në vitin 1877, dhe elita fetare e të tri konfesionëve në Stamboll, formuan

¹⁸ Një formë për model e politikës serbe është edhe kryengritja shqiptare në vitin 1912 kur shqiptarët kishin marrë Kosovën dhe kishin depërtuar edhe në Shkup. Në krye të kësaj kryengritje ishte Isa Boletini, të cilin historiografia shqiptare sot gati se e krahason me Skënder Beun. (shih për shembull veprën e Skënder Laurasit: Isa Boletini, Rilindja Prishtinë 1972.). Isa Boletini armët i ka marrë nga Serbia. Serbia rregullisht e ka përkrahë atë që ai të mos ngrihet kundër deri në çastin, atëherë kur asaj do t'i konvenonte më së shumti. Për kemi një mori dokumente në arkivin e SIP, dokumente të cilat, shpresoj shumë shpejtë do të botohen. Lidhur me këtë do të japim disa të dhëna nga dorëshkrimi i Janiqije Popoviqit “Zivot i rad srba na Kosovo”. Ky dokument ruhet në arkivin e Kosovës në Prishtinë. Janiqije Popoviq ka qenë dëshmitar i ngjarjeve dhe ka qenë i kyçur në aktivitetet e serbëve në Kosovë.

“Komitetin për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptarë”, në ballë të së cilit ishte Sami Frashri, pa dyshim intelektual i madh shqiptar i asaj kohe. Komiteti shqyrtoi edhe bashkëpunimin me popujt tjerë të Ballkanit. Duke marrë parasysh qasjen e lartpërmendur rreth prejardhjes së përbashkët të shqiptarëve dhe grekëve dhe atë që edhe më parë ka pasur përpjekje për bashkëpunim dhe kufijve të përbashkët dhe përbërja e popullsisë, kishin ardhur në përfundim se aleatin duhet kërkuar në Greqi. Andaj edhe në tetor të vitit 1877 kishin filluar bisedimet mes përfaqësuesve të Komitetit me një personalitet të autorizuar të qeverisë greke. Pala shqiptare kërkonte që Greqia formalisht t’i ofrojë garanci në tërësinë territoriale të Shqipërisë, e që kufiri jugor do të përfshinte trevat e banuara me shqiptarë të vilajetit të Janinës bashkë me Çamërinë dhe përgjatë bregut deri në Prevezë, kurse qyteti i Janinës dhe trevat nën lumin Kalams do t’i bashkëngjiteshin Greqisë. Me këto kushte, nëse do të arrihej në formimin e shtetit shqiptarë, Komiteti ishte i gatshëm të pranonte një princ grek në krye të shtetit shqiptar. Mirëpo, grekët kërkonin që gjitha trevat duke përfshirë edhe Gjirokastrën, Delvinën dhe Përmetin, e që pala shqiptare nuk mund të pranonte një kërkesë të tillë. Në fillim të vitit 1878, atëherë kur në këto anë u paraqitën edhe bandat greke, bisedimet u ndërprejnë dhe u zbrapsen në formimin e federatës shqiptare-greke,¹⁹ edhe pse më vonë ka pasur përpjekje të njëjta, por pa sukses. Nga gjithë popujt tjerë të Ballkanit, grekët më së paku kanë dashur ta kuptojnë çështjen shqiptare.

Ky komitet i Stambollit ka vënë në pah nevojën e mbajtjes së marrëdhënieve miqësore me popujt fqinjë të shqiptarëve. Në deklaratën e publikuar, më 30 maj të vitit 1878, ndër të tjera thuhet: “Ne gjithsesi duam të jetojmë në paqe me fqinjët tanë, Malin e zi, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë. Ne asgjë nuk kërkojmë nga ata, por jemi thellë të vendosur që me çdo kusht të mbrojmë gjithë ajo që është e jona. Tokat shqiptare duhet t’u lihen shqiptarëve”.²⁰

¹⁹ Për më tepër shih “*Historia e popullit shqiptar II*”, 94-97.

²⁰ *Historia e popullit shqiptar II*, 118.

Në vitin 1878, në një promemorie drejtuar ambasadës së Anglisë në Stamboll nga ana e një shqiptari (supozohet se ai ka qenë Vaso Pasha, për të cilin do të flitet më poshtë) ndër të tjera thuhej: “Nëse është e drejtë të formojnë shtete të pavarura apo autonomi popujt sllavë, është më se e qartë se shqiptarët nuk mund të pajtohen me një administratë të kalbur, të cilën e kishin deri tani. Ata janë më se të bindur se qeveria turke nuk donë dhe nuk mund t’u ofrojë një administratë më të mirë. Ata janë të vendosur që të ndërpresin gjitha lidhjet që i kanë me Turqinë. Ata kërkojnë një administratë të veçantë, e cila më tepër u përgjigjet nevojave të tyre, si dhe kërkojnë një garanci. Shqiptarët, me të drejtë kërkojnë t’i bashkëngjiten familjes së madhe evropiane, pjesë e së cilës janë.”²¹

Ne tanimë kemi cekur se Lidhja e Prizrenit i kishte formuluar kërkesat e shqiptarëve për autonomi politike dhe emancipim kulturor.

Mirëpo, gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit vjen deri te një acarim mes raporteve, në njërën anë pala shqiptare dhe në anën tjetër popujt tjerë të Ballkanit.²² Vlen të theksohet se pikërisht atëkohë te disa ideologë të lëvizjes nacionale shqiptare, lind ideja për bashkëpunim dhe luftë të përbashkët. Ideologu ma i madh i lëvizjes nacionale shqiptare, Sami Frashri,²³ në të njëjtën kohë leksikologu, filologu dhe enciklopedisti më i madh, gjatë kohës së Kongresit të Berlinit, në Stamboll boton gazetën ”Tercüamani Şark”. Në disa artikuj ai shkruan për problemin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe rrezikun më të madh për gjithë Ballkanin e sheh në okupimin e Bosnjës nga ana e Austro Hungarisë

²¹ Vep. cit, 120.

²² Vep. cit, 120.

²³ Ekziston literaturë e pasur për Lidhjen e Prizrenit, por punimi më solid është ai i Bernard “Çështja shqiptare 1875-1882”, JAZU, v. 313, Zagreb 1959. Në historiografinë shqiptare nuk kemi ndonjë punim serioz. Por në arkivat e Stambollit, Vjenës, Romës dhe në arkivat e shteteve fqinje ka me mijëra dokumente, prej të cilave gati se fare nuk janë hulumtuar. Vetëm pasi të jenë botuar dokumentet elementare nga këto arkiva mund të jepet një gjykim i drejtë.

dhe shtrirjen e saj në Sanxhakun e Novi Pazarit. Do të citojmë disa pjesë të artikullit të tij:

“Shqiptarët janë të shtrënguar dhe të frikësuar nga njëra anë nga popujt sllav dhe nga ana tjetër nga grekët. Mirëpo, tani në Bosnjë është paraqitur edhe një fuqi e huaj e cila synon të okupojë Bosnjën. Duke kuptuar se gjenden para rrezikut të përbashkët, myslimanët, ortodoksët sllavët dhe katolikët e Bosnjës të gjithë së bashku i kishin kapur armët, atyre gjithashtu u kishin dalë në ndihmë edhe fqinjët shqiptarë. Në të njëjtën kohë filloi edhe vëllazëria me serbët dhe me malazezët, edhe pse për shekuj me radhë kishin luftuar kundër njëri-tjetrit. Pa dyshim që të gjithë boshnjakët, myslimanë e katolikë u ngritën kundër okupimit të Austro Hungarisë dhe në marrëveshje me shqiptarët. Uniteti mes boshnjakëve, serbëve dhe malazezëve është i qartë, nëse Bosnja dhe Hercegovina kalon në duart e një fuqie të madhe, kush do ta garantonte ardhmërinë e Serbisë së vogël dhe Malit të Zi jo të qëndrueshëm? Rusia nuk donte pavarësi të plotë të popujve sllav të jugut, ajo do që këta popuj gjithmonë të jenë nën pushtetin e dikujt tjetër, dhe ajo të mund të bënte intriga dhe t’i përdorë si armë në duart e saja”.

Sa i përket marrëveshjes serbo-malazeze dhe shqiptare, që tri javë kjo marrëveshje është tejet aktuale. Vërtet, serbëve dhe malazezve një marrëveshje me shqiptarët, të cilët kanë formuar Ligën e tyre, mund t’ju duket e çuditshme, por nëse mendojnë mirë, do ta kenë të qartë se një marrëveshje e tillë është më se e domosdoshme”.

Bazuar në disa lajme telegrafike, vazhdon Sami Frashri, serbët dhe malazezët duhet të dërgojnë delegatët e tyre në Lidhjen e Prizrenit dhe pa dyshim që do t’i rregullojnë mosmarrëveshjet që kanë mes veti. Nëse arrihet kjo marrëveshje mes popujve sllav të jugut dhe shqiptarëve, ata së bashku do t’ia dalin t’i kundërvihen Austro Hungarisë, dhe nuk është vështirë të besohet se do të paraqiten turbullira mes hungarezëve dhe popujve sllav, të cilët Austria i mban të okupuar. Sa i përket Greqisë edhe ajo është e rrezikuar nga Austria, e cila do që të shtrihet deri në ujdhesat greke, andaj edhe ajo duhet të ndjekë shembullin e Serbisë

dhe Malit të Zi, por të lë mënjanë idetë zaptuese dhe t'i bashkohet kësaj lidhje, çështje e cila do të ishte tejet e dëshirueshme".²⁴

Deri më sot nuk kemi kurrfarë argumente rreth këtyre bisedimeve, në njërën anë serbëve dhe malazezëve dhe në anën tjetër përfaqësuesve të Lidhjes së Prizrenit, por meqë rreth kësaj teme shkruan Sami Frashri, i cili ka qenë njaft mirë i informuar dhe vetë ai ka qenë ideolog i saj dhe i gjithë lëvizjes nacionale, atëherë nuk guxojmë që shkel e shko të kalojmë rreth kësaj çështje.

Në të njëjtën kohë një shqiptar tjetër, Jusuf Ali Begu, me prejardhje nga Kërçova, vepron në Kosovë dhe në Dibër si organizator i rezistencës kundër Turqisë. Ai në Sofje ka botuar një vepër rreth rrjedhave politike në trojet shqiptare. Ai në këtë vepër prezanton qëllimet e lëvizjes. Në vepër janë shfaqur kërkesat në emër të prijësve shqiptarë myslimanë e të krishterë nga Dibra, nga Mati, nga Malësia, nga Mirëdita, nga Prizreni, nga Elbasani dhe qyteteve tjera. Ai më tej shkruan, se shqiptarët janë të gatshëm me armë në dorë, me çdo çmim, të mbrojnë lirinë e atdheut të tyre. Jusuf Ali Begu në Edrene, në gjuhën turke, ka botuar edhe një broshurë në të cilën ka prezantuar planin e ardhshëm për organizimin e Shqipërisë. Ai më tej thotë: "është më se e domosdoshme që nga Shqipëria të formohet një principatë". Ai propagandon vëllazëri me gjithë popujt sllav, duke thënë "interesi i vetëm i shqiptarëve është që të kenë marrëdhënie miqësore me principatat fqinje të popujve sllav". Më vonë Jusuf Ali Begu në Sofje ka botuar dy gazeta në gjuhën turke "Dikkat" dhe "Tarla". Gazeta e dytë është gazeta e parë turke e cila merret me çështje agrare.²⁵

Njëri ndër shkrimtarët më të mëdhenj nga periudha e rilindjes, Naim Frashri, në vitin 1886 në Bukuresht ka botuar poezinë lirike në gjuhën greke me titullin "Dëshira e vërtetë e shqiptarëve". Në këtë po-

²⁴ Për më shumë për Sami Frashrin shih: Aga Sirri Levent "Semsetin Sami, Türk Dil Kurumu", Ankara 1967. Hasan Kaleshi, "Sami Frashri në letërsinë dhe filologjinë turke", Gjurmime albanologjike 1, Prishtinë 1968, 33-106.

²⁵ Tercümani Şark, 3/17, gusht 1878.

ezi Naimi nuk u drejtohet vetëm shqiptarëve, por edhe popujve tjerë të Ballkanit që së bashku të luftojnë kundër Turqisë. Naimi, një humanist i madh dhe luftëtar për ngritjen e vetëdijes nacionale përmbi dallimeve fetare, ide kryesore e intelektualëve shqiptarë. Kjo ide ishte që populli të jetojë në harmoni dhe në paqe me popujt tjerë dhe që popujt e Ballkanit, të ndihmojnë njëri-tjetrin si dhe të respektohen mes veti. Do të sjellim një strofë të kësaj poezie, të përkthyer së pari nga greqishtja në shqipe, kurse ne e kemi përkthyer në serbisht nga gjuha shqipe:

Me fqinjët gjithmonë duam në paqe të jetojmë,

Me sllavët, me grekët dhe me të tjerët në dashuri të jetojmë,

Shikimet e secilit thellë t'i kuptojmë,

Të drejtën e tjetrit gjithmonë ta respektojmë.²⁶

Një ndër figurat kryesore të lëvizjen nacionale shqiptare ka qenë edhe Vaso Pasha.²⁷ Ai në vitin 1879 në Paris dhe në Berlin ka botuar veprën “E vërteta rreth Shqipërisë dhe shqiptarëve”²⁸ në gjuhën frënge, greke dhe turke. Në këtë vepër Vaso Pasha apo Vaso Efendiu, siç e hasim shpesh në veprat të shkruara në frëngjisht, ndonëse ai ka qenë edhe funksionar i lartë i Portës, ai ofron një pasqyrë të shkurtë për historinë e popullit shqiptarë. Ai vë theksin në kërkesat e popullit shqiptarë, pi-

²⁶ Një masë e madhe e materialeve rreth Jusuf Ali Begut, i cili ka bashkëpunuar me M. A. Hitrovën, kur ki i fundit gjatë viteve të gjashtëdhjeta ka qenë konsull rus në Manastir, gjendet në arkivin M.A. Hitrov “Shtëpia e Pushkinit” në Leningrad. Gjithashtu rreth kësaj teme materiale ka edhe në Arkivin I. G. Senkeviq “Çështja shqiptare dhe kriza lindore”, Moskë, 1965, 119. Broshura e tij është botuar më 1878, me urdhrin e Komisarit në Bullgari A.K. Dondukopv – Korsakova në tipografinë e kancelarisë diplomatike në Edrene

²⁷ *Historia e popullit shqiptar II*, 468.

²⁸ Vaso Pasha apo Vaso Efendi është lindur në Shkodër në vitin 1825. Në vitin 1849 ka marrë pjesë në kryengritjen e Venedikut kundër Austro Hungarisë, nga aty ka kaluar në Turqi. Përkundër asaj që ishte i krishterë, në vitin 1879 ishte caktuar për këshilltar në vilajetin e Edrenesë, dhe kishte marrë titullin pasha. Katër vjet më pas u bë vali në vilajetin e Libanit, aty edhe vdiq në vitin 1892. Ka botuar disa vepra në frëngjisht, me motive nga jeta shqiptare. Gjithashtu ka botuar edhe një përmbledhje në italisht dhe pak botime në shqip. Veprat e tija të botuara në frëngjisht janë përkthyer në gjuhën shqipe.

kërisht në vorbullën e ngjarjeve gjatë kohës së mbajtjes së Lidhjes së Prizrenit. Por ai është mjaft i matur, duke pasur parasysh realitetin politik të asaj kohe. Ai kërkon formimin e një vilajeti shqiptar, dhe me këtë gjithë elementet vendore do ta gjenin veten në administratën publike, ku ligji do të ishte i njëjtë për të gjithë. Ai për mostër, rreth organizimit të atij vilajeti, merr Zvicrën, ku të gjithë popujt dhe pjesëtarët e të gjitha feve të kenë të drejta të barabarta.²⁹

Historiografia shqiptare vetëm viteve të fundit i ka kushtuar rëndësi të konsiderueshme një tubimi të madh shqiptar në Pejë, i cili është mbajtur nga 26-30 janar të vitit 1899, në krye të së cilës ka qenë Haxhi Zeka.³⁰ Pa u thelluar në vetë tubimin, motivin, qëllimin dhe pasojat e atij tubimi, ne me këtë rast do të përqendrohemi vetëm në një pjesë të deklaratës së liderit të atëhershëm kosovar Ferhat Dragës, djali i feudalit nga Mosjtira e Rozhajës, Ali Dragës dhe në të njëjtën kohë vëlla i politikanit më me zë të Kosovës Nexhip Dragës, më vonë themelues i “Xhemijetit” në vitet e njëzeta të shekullit XX.³¹ Dhjetë ditë para fillimit të tubimit në Pejë, Ferhat Draga³² i ka dhënë një deklaratë një politikani serb, se pozita e serbëve në Vilajetin e Kosovës është më se e vështirë dhe se ata iu janë nënshtruar një agresiviteti dhe ashpërsie nga ana e shqiptarëve. Mirëpo ai vazhdoi se gjitha të këqijat vijnë nga pushtetarët turq, të cilët nuk i ndëshkojnë shkelësit e ligjit, dhe se turqit janë indiferent dhe në mënyrë të heshtur i trimërojnë që të sillen keq ndaj serbëve. Në të njëjtën kohë Ferhat Draga nënvizon se shqiptarët do t’i kishin falënderuar serbët, sikur serbët të kishin lejuar formimin e një komiteti shqiptarë në Beograd, nëpërmjet të cilit lehtë do t’i kishin shpërndarë literaturën nga diaspora në trojet shqiptare. Lidhur me vetë

²⁹ P. Wasa, *La veritésur l’Albanie et les Albanais*, Paris 1879.

³⁰ Pjesët e lartcekura të Vaso Pashës, i kemi cituar sipas Historia e popullit shqiptar II, 444.

³¹ Hasan Kaleshi – Isame Dermaku Dokumente nga arkivi i Vjenës mbi lidhjen e Pejës, Vjetari i Arkivit të Kosovës, IV-V, Prishtinë, 1972, 149-205.

³² Për Nexhip Dragën shih artikullin tim në: Biographisches Lexicon zur geschichte Südosteuropas, Südosteuropäische Arbeiten, 75 Leif.3.

tubimin në Pejë ai qartë tha: “Ne përveç shqiptarëve do të ftojme edhe përfaqësuesit e serbëve që të prezantojnë në këtë tubim, sepse nuk duam që asgjë të bëjmë pa serbët. Atëherë kur ta fitojmë autonominë gjithçka do të jetë në rregull. Serbët do të jenë të lirë dhe të qetë. Unë ju dëshmoj se me shkuarjen e pushtetit osman gjithçka do të jetë në rregull, sepse tani edhe shqiptarët jetojnë njëjtë në kushte të vështira sikur edhe serbët.”³³

Ne jemi ndalur në këto ide të Ferhat Dragës, sepse atëkohë ide të tilla në mesin e shqiptarëve në Kosovës ka pasur mjaft pak. Ka të ngjarë që idetë e Ferhat Dragës rreth krijimit të një komiteti në Beograd kanë ngacmuar politikanët serb të asaj kohe, sepse që në vitin 1902 në Beograd vepronte një komitet i ngjashëm, i cili që nga viti 1902 e deri në vitin 1904 botonte gazetën “Albania” (Publiésous la direction d’un comité). Fatkeqësisht rreth atij komiteti dhe aktiviteteve të tij kemi shumë pak informata, sepse prej rreth 30 numrave të asaj gazete, janë ruajtur vetëm dy numra në Bibliotekën Kombëtare në Beograd dhe një numër në Bibliotekën Matica Serbe në Novi Sad. Mirëpo, edhe nga këta tre numra të asaj gazete mund të shihet se rolin kryesor e ka luajtur Jashar Erebara,³⁴ atëkohë publicist i njohur shqiptar, e që figuronte si pronar i gazetës, si dhe Nikoll Ivanaj, më vonë botues i disa gazetave dhe autor i disa veprave në gjuhën shqipe, edhe pse emri i tij nuk përmendet në mënyrë eksplicite.³⁵ Siç duket komiteti ka luajtur pikërisht

³³ Ferhat Draga në vitin 1921, pas vdekjes së të vëllait të tij Nexhipit, u zgjodh kryetar i “Xhemijetit”, dhe ka qenë delegat në Kuvend. Me një rast, i manipuluar nga Pashiqi, shkaktoi rënien e qeverisë. Më vonë është akuzuar për tradhti, është burgosur dhe është gjykuar me 101 vjet burg, për një kohë është amnistuar, por me pa të drejtë të zgjidhet delegat për në Kuvend. Gjatë okupimit ka qenë një ndër udhëheqësit e ideologëve të “Shqipërisë së madhe”. Ka vdekur në vitin 1945.

³⁴ Dokumenti shqiptar i përkthyer në tërësi është botuar në punimin e lartcekur të H. Kaleshit dhe I. Dermakut në f. 159-162.

³⁵ Si duket Jashar Erebara ka qenë me prejardhje nga Dibra apo nga rrethina, edhe pse gjithmonë ka qenë i sulmuar në disa gazetave beogradase. Na viti 1911-1912 ka botuar gazetën “Shkupi”, me seli në Shkup. Gazeta është botuar me dy faqe në gjuhën shqipe dhe me dy faqe në gjuhën turke. Gjatë periudhës së Ahmet Zogut ka qenë delegat në Kuvendin popullor.

rolin të cilin kishte parashikuar Ferhat Draga, sepse në numrin 30 të datës 7.1.1904 është botuar një shpallje në gjuhën serbe drejtuar shqiptarëve. Në atë shpallje thuhej se shqiptarët në diasporë në këto ditë të vështira, sidomos të vështira nga aspekti arsimor, letrar, kanë shkruar përkthyer dhe kanë hulumtuar trashëgiminë e lashtë dhe ia kanë afruar të botuar popullit! Për t'i njoftuar arnautët të cilët jetojnë në Serbi, apo kudo qoftë jashtë saj dhe lexojnë gazetën tonë me letërsinë tonë, redaksia e gazetës “Albania” ka grumbulluar mjaft vepra të këtilla dhe punime dhe ua ka lënë në deponim bashkëkombësve të vet. Në redaksi gjenden punimet letrare, historike dhe poetike, të gjitha në origjinal të bashkëpunëtorëve tanë. Gjenden përkthime nga gjuha greke, latine dhe nga gjitha gjuhët tjera në gjuhën tonë amtare, si dhe gjitha tekstet shkollore nga klasa e parë e shkollës fillore e deri në klasën e katërt të gjimnazit. Mjaft prej tyre janë botuar edhe në alfabetin cirilik. Secilit që u nevojiten le të urdhërojë në redaksi të Knez Mihajl, rruga nr. 23, ose le të drejtohet me letër, me kartolinë, e redaksia do t’ia dërgojë.

Nuk ka të dhëna se cilat vepra janë shpërndarë nga ky komitet dhe ku janë shtypur, por se ky komitet është marrë me shpërndarjen e librave dhe gazetave, gjejmë dëshmi në letrën e një lexuesi nga Mitrovica, të cilën ia kishte dërguar redaksisë dhe botuar në gazetën “Maqedonia” të datës 15.11.1904. Aty autori i letrës kërkon që në gjuhën shqipe të shtypet abetarja dhe tekste tjera, por me alfabet cirilik, ne thjesht habitemi se si ju atje keni lejuar që në Austri të botohen libra nëpërmjet Serbisë dhe nga Serbia të dërgohen në këto anë? Nga konsulli austriak në Mitrovicë shpërndahet gazeta “Albania” dhe një abetare e botuar me alfabet latin dhe shqiptarëve u shpërndahen falas... Si keni lejuar që në mes të Beogradit të botohet gazeta me alfabet latin në gjuhën shqipe?!”

Ne kemi cituar shpalljen e lartpërmendur të komitetit e kemi publikuar gati të tërin, sepse sipas mendimit tonë ka domethënie të shumëfishtë. Ajo shpallje para se gjithash tregon se komiteti nuk ka pasur vetëm synime politike, por edhe synime arsimore dhe kulturore. Derisa

botimi i atyre veprave është financiar nga ana e Austro Hungarisë, e që botimit iu është bashkëngjitur edhe shoqëria e Bukureshtit dhe Sofjes, është më se e qartë, se Komiteti i Beogradit ka mbajtur lidhje të ngushta dhe bashkëpunim të përhershëm me ato shoqëri. Beogradi ka shërbyer si lloj stacioni transitor për shpërndarjen e literaturës në Kosovë dhe në viset tjera të Perandorisë Osmane të banuara me shqiptarë. Edhe një fakt tjetër që nuk duhet anashkaluar në shpallje përmendet se mjaft prej atyre veprave janë botuar me alfabet cirilik. Sipas mendimit tonë, ato vepra duhet të jenë të botuar në Beograd, sepse nuk jemi në dijeni se në ndonjë vend tjetër të jenë botuar vepra shqipe me alfabet cirilik. Fatkeqësisht askund nuk ia kemi dalë të gjejmë ndonjë nga këto vepra, e as ndonjë shënim për ato vepra, andaj çfarëdo informate rreth atyre veprave do të ishte tejet me interes për kulturën shqipe dhe në të njëjtën kohë edhe për historiografinë. Kjo do të hidhte dritë në marrëdhëniet shqiptaro-serbe deri tani të panjohura. Ajo që veprat janë botuar me alfabet cirilik, gjithsesi me ndihmën e qeverisë serbe nuk do të thotë që qeveria serbe ka dashur t'ia imponojë shqiptarëve alfabetin cirilik, sepse shqiptarët atëkohë nuk kishin alfabetin e tyre unik. Ata shërbeheshin me disa alfabete, si alfabetin latin, grek, arab. Ka pasur tentativë t'u imponohet edhe alfabeti cirilik rus, por që nuk ka ndonjë vepër të botuar me këtë alfabet. Konsiderohet se qeveria serbe e kishte parë të arsyeshme që të punohet në ngritjen kulturore të shqiptarëve, e që qartë shihet edhe në disa artikuj të gazetës “Albania”. Kjo më vonë të bie në harresë, aq më tepër me intensitet punohej që të mbahej prapambetja shoqërore dhe kulturore.

Në po këtë numër të gazetës “Albania” është botuar një artikull në gjuhën serbe, me autor anonim, i cili mban titullin “arnautët dhe serbët”. Nuk mund të konstatohet se a kemi të bëjmë me një artikull të redaksisë, apo atë artikull e ka shkruar ndonjë serb, i cili për shkak të oportunitetit politik nuk është identifikuar. Si do që të jetë, autori e ka parë të domosdoshme bashkëpunimin mes shqiptarëve dhe serbëve dhe ka bërë me dije cakun ku duhej të arrinte qeveria serbe. Ai insistonte

në bashkëpunimin mes dy popujve, fati i kishte bërë që ata 1500 vjet të jetonin dhe punonin bashkërisht. Ai vë në pah pjesëmarrjen e shqiptarëve dhe serbëve në lëvizjet të krishtera të përbashkëta kundër Turqisë. Në artikullin më tej, gjithashtu ceket se, edhe lëvizja e pastër serbe e shekullit të kaluar nuk ka qenë edhe pa një simpati të veçantë të shqiptarëve karshi serbëve. Për dëshmi rreth kësaj ai cekë heroin Konda Binbashin dhe të tjerët. Në fund autori përfundon se sot më shumë se kurrë atij fisi duhet t'i dilet në ndihmë në fushën e arsimit dhe kulturës. Serbia dhe serbët duhet të parët të jenë që t'i ndihmohet atij populli në rrugën e rilindjes, sepse populli serb dhe shqiptarët janë ata që kanë ndarë dhe do të ndajnë të mirën dhe të keqën në jetën e tyre. Shqiptarëve duhet t'u dilet në ndihmë që të arsimohen dhe të njihen me të kaluarën e tyre të vërtetë dhe tek atëherë do të ngadhënjejë e vërteta dhe e drejta.

Ndihmojini shqiptarët të hapin shkolla dhe të arsimohen. Kjo kërkohet nga populli serb. Në gazetën e datës 10 dhjetor të vitit 1902, ndër të tjera thuhet: “Serbët dhe shqiptarët medoemos duhet të jetojnë në miqësi dhe me forca të përbashkëta, të mbrojnë vatrat dhe atdheun e tyre nga armiku i përbashkët.”

Duhet besuar se gazetën “Albania” e ka financuar qeveria e Serbisë, edhe pse në një numër të saj kërkohet ndihma morale dhe materiale që të mund të vazhdojë botimi i gazetës dhe t'i mbrojë interesat dhe të drejtat e shqiptarëve në mesin e kombeve tjera të Ballkanit.”

Edhe pse gazetën e ka financuar Serbia, kjo nuk duhet të jetë shkak për mosinteresimin e të dhënave të kësaj gazete,³⁶ sepse shumë gazeta

³⁶ Nikolla Ivanaj femërinë e ka kaluar në Podgoricë. Në vitin 1900, me rekomandimin e Shahin Kolonjës është vendosur në Beograd. Kolonja në Sofje botonte gazetën “Drita”, kurse në Beograd bënte propagandë për çlirimin e Shqipërisë. Sipas rrëfimeve të tij, në Beograd është pritur mirë dhe është punësuar si përkthyes në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Pikërisht atëkohë bashkë me Jashar Erebaren ka punuar në botimin e gazetës “Albanija”. Në vitin 1905 nga Beogradi është transferuar në Dubrovnik. Atje filloi të botojë gazetën “Shpnesa e Shqipënies”. Brenda pak kohe kishte kaluar në Trieshtë, aty edhe vazhdoi të botojë të njëjtën gazetë. Informatorët e Austro-Hungarisë shkruajnë për te mjaft në mënyrë jo të fa-

që janë shtypur në diasporë, si në Stamboll, në Sofje, në Bukuresht, në Bruksel, në Itali edhe atje larg në Egjipt dhe në Amerikë, janë financiar dhe kanë pasur donacione nga Turqia, Austro-Hungaria, Italia ose Bullgaria.³⁷ Fundja të njëjtin fat e kanë pasur edhe gazetat e emigrantëve të popujve tjerë që kanë luftuar për lirinë e tyre. Bazuar në këta tre numra, mund të konstatohet se gazeta “Albania”, atë kohë ka gëzuar të gjitha liritë që kanë gëzuar edhe gazetat tjera në Serbi. Kredo e gazetës ka qenë, siç edhe shihet qartë edhe në numrin e datës së 28 qershorit të vitit 1902, se “Ballkani i ballkanasve, pra Shqipëria e shqiptarëve. Interesi kryesor i serbëve dhe shqiptarëve është që të krijojnë harmoni dhe dashuri mes këtyre dy popujve dhe të hidhen vija të qarta për një emancipim nacional.” Në numrin e kësaj gazete të datës 15 mars të vitit 1903 ndër të tjera thuhet: “Mund të konstatojmë një fakt se programi jonë i punës është që dita ditës të arrihet afrimi i shqiptarëve dhe serbëve dhe një miqësi sa më madhe në mesin e personaliteteve të shquara të shqiptarëve dhe atyre serbe, e që kjo është një garanci që puna jonë të kurorëzohet me sukses.”

Analiza e këtyre tre numrave që trajton gazeta, është thelbi i problemeve vitale të popullit shqiptar, si problemi i autonomisë, i çlirimit, arsimimit nacional, agjitimit, që çështja nacionale të ngritët sipër çështjes fetare. Aty hasim edhe kritika karshi fuqive të mëdha etj. Ne nuk shohim ndonjë ndryshim të kësaj gazete në krahasim me gazetat tjera shqiptare të cilat shtypeshin në Sofje, në Bukuresht dhe në vende tjera. Në një artikull hasim edhe këtë mendim: “Turqia, Rusia dhe disa fuqi tjera të mëdha i dinë mirë dhe i kanë të qarta këto çështje, por shtiren se nuk i dinë, për të vetmen arsye, se interesi i tyre ishte të flasin dhe të

vorshme, duke e akuzuar se në fillim ka qenë në shërbim të qeverisë serbe e më vonë edhe italiane. Në ato raporte ka një detaj tejet interesant se ka qenë sekretar i Mark Millanit. Mirëpo, në veprën e tij “Historia e Shqipënisë së Re”, Tiranë I-II, 1943-1945, vepër në të cilën shkruan kryesisht për kujtimet e veta, nuk përmend një të dhënë rreth kësaj teme.

³⁷ Në “Historinë e popullit shqiptarë” dhe në “Historia e letërsisë shqipe” flitet mjaft për gazetarinë shqiptare, por në asnjë vend nuk përmendet kjo gazetë.

gënjejnë karshi botës se ne nuk jemi të denjë për ndonjë të mirë dhe për diç të mençur, por që jemi rebel, të egër dhe të pabesueshëm, andaj të gjithë meritojmë shpatën dhe litarin.³⁸ Fitohet përshtypja se ekziston dallim i konsiderueshëm i artikujve të botuar shqip dhe disa artikujve në serbisht, kur flitet për Turqinë dhe kryengritjen e shqiptarëve në Kosovë: artikujt në gjuhën serbe janë mjaft të matur kur kemi të bëjmë me Turqinë dhe reformat e saja politike në Maqedoni dhe në Kosovë. Kjo ishte një situatë gati e ngjashme në tërë gazetarinë e asaj kohe të Beogradit, kurse sa i përket artikujve në gjuhën shqipe ishin tejet të papajtuësishëm, të ashpër dhe haptas qëndronin në mbrojtje të lëvizjes shqiptare, gjykoheshin reformat politike dhe administrative, dhe theksonin se shqiptarët nuk janë kundër reformave, por përkundrazi janë për reforma, por për reforma të drejta dhe të vërteta. Andaj edhe në numrin e datës 7 mars të vitit 1904 thuhet: “Turqit çdoherë fajin ia hedhin shqiptarëve dhe se ata duan të zbatojnë reformat, por ja që shqiptarët nuk duan. Por, dihet që shqiptarët i duan të drejtat që i gëzojnë edhe popujt tjerë. Si mund të thonë turqit se shqiptarët janë kundër reformave?! Shqiptarët kur panë se Turqia është duke dhënë shpirt, atëherë filluan të mendojnë për fatin e tyre. Janë ngritur dhe kërkojnë të drejtat e tyre si popull i veçantë, që edhe ata si gjithë popujt tjerë të Ballkanit të qeverisin me vetveten. Nuk është e vërtetë atë që e thotë Turqia dhe Austro-Hungaria, se shqiptarët janë ngritur kundër reformave. Ato janë gënjeshtër të kulluara të këtyre shteteve. Turqit e kanë për qejfi të thonë, se shqiptarët janë ngritur kundër reformave vetëm e vetëm që reformat të mos zbatohen në Shqipëri, kurse llogaria e austriakëve është që shqiptarët t’i paraqisnin si zullumqarë, e më pas të hynin

³⁸ Austro-Hungaria, ndër të tjera ka financuar edhe këto gazeta: gazetën “Drita”, në Sofje, të cilën e kanë botuar Shahin Kolonja dhe Kristo P. Laurasi; gazetën “Kombi”, në Boston, SHBA, të cilën e ka botuar Sotir Peci; gazetën “Toska” në Egjipt nga viti 1901-1903, të cilën e ka botuar Milo Duçi; gazetën “Besa” në Kajro, të cilën e kanë botuar Fokion Turtuli; gazetën “Albanija” në Bruksel, të cilën e ka botuar Faik Konica; gazetën “Albanie”, në Gjenevë, të cilën e ka botuar Dervish Hima. (Hans Sieter Schadel, die Albanien politik).

në Shqipëri dhe t'i "emanciponin" ashti siç kishin vepruar me boshnjakët. Andaj, me një energji tejet të madhe duhet punuar që Shqipëria të shpëtohet nga duart e Turqisë."

Sa i përket bashkëpunëtorëve të gazetës, bazuar vetëm në tre numra, është tejet e vështirë të jepet një gjykim, por karshi Ivanisë, kemi hasur në artikullin e patriotit dhe shkrimtarit të njohur shqiptarë Jani H. Mihajlit³⁹ dhe një letër të publicistit të asaj kohe prof. Gasper Jakovës.⁴⁰

Ne edhe më lartë kemi cekur se hulumtuesit shqiptarë e kanë lënë anash gazetën "Albania" (titulli në shqip ka qenë Shqipnija e Shqiptarvëtë – Shqipëria e shqiptarëve) ndoshta duke besuar se ajo ka qenë armë në duart e politikës serbe karshi Kosovës. Kjo nuk mund të thuhet në asnjë mënyrë, nuk qëndron. Nuk ka kurrfarë indikacioni për një orientim të tillë të kësaj gazete. Deri në ç'skallë artikujt në gazetën "Albania" nuk i kanë shkuar për shtati disa qarqeve të Beogradit, më së miri mund të shihet nga artikulli në gazetën "Maqedonija", drejtor i së cilës ka qenë P. Simonoviç. Gati sa nuk ka numër të kësaj gazete të vitit 1904 e të mos sulmohet Jashar Erebara dhe gazeta "Albania". Andaj më datë 18.1.1904 shkruan "... ah sa jemi tradhtuar ne në Serbi me një individ dhe sa e ndihmojmë dhe lejojmë që në mes të Beogradit të shtypet një gazetë shqiptare me alfabet latin, gazetë e cila në Vjenë redaktohet në gjuhën shqipe. Dihet, sepse është argumentuar se redaktor i asaj gazete është nga Bosnja, ai është boshnjak e nuk është shqiptar edhe pse ai deklarohej." Në numrin e datës 14 dhjetor të vitit 1904 sulmohet redaktori, duke u akuzuar si agjent, duke i dërguar thirrje Ministrisë së Punëve të Brendshme që t'i anulohet mikpritja, kurse shtypi ftohet që ta sulmojnë, sepse në pjesën evropiane të Turqisë ka

³⁹ Lehova ka qenë avokat në Koshtancë të Rumanisë. Nga viti 1912-1914, Koshtancë, ka botuar gazetën "Atdheu".

⁴⁰ Don Gasper Gjakova ka qenë mentori kryesor i pretenduesit për kurorë shqiptare, princit rumun Gjikës. Për më tepër shih Edit Durham, *Twenty years of Balkan Tangle*, Londër 1920; NNsta, RA XIV, Liasse (Princ Albert Ghica 1904-1912).

1.600000 shqiptarë në anën tjetër vetëm 500 000 serbë. Mirëpo, në rastin konkret për ne tani është me rëndësi se gazeta “Maqedonija” për t’iu kundërvë gazetës “Albania” dhe ndikimit të saj te shqiptarët, kishte filluar të publikojë artikuj në gjuhën shqipe me alfabet cirilik me pseudonimin “Nji shiptar”. Nuk është mjaftuar vetëm me kaq, në gazetë kemi një varg lajmesh për formimin e një këshilli “për konsolidimin e një alfabeti shqiptar dhe alfabetit cirilik”, në atë mënyrë do të konsolidohej komiteti shqiptar, i cili do të kontaktonte me shoqatat tjera kulturore në Evropë. Komiteti do të botonte një gazetë në gjuhën shqipe, serbe dhe turke, kështu që shqiptarët do të dëgjonin opinionin nga Serbia dhe mendimin e serbëve karshi tyre dhe shtetit të tyre, kurse në numrin e datës 28.IX.1904 kemi lajmin me titullin “Liga shqiptare”, ku hasim se “brenda pak ditësh do të formohet një ligë shqiptare me qendër në Beograd dhe do të ketë nën komitete në brendi të Serbisë. Kjo shoqatë me themelimin e saj do të ketë edhe gazetën e saj në gjuhën turke dhe në gjuhën shqipe, dhe do të përfaqësojë interesat e Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Liga në të njëjtën kohë do të botonte edhe vepra në gjuhën shqipe, sepse paraprakisht nga po e njëjta ligë, do rregullohej çështja e alfabetit për gjuhën shqipe. Konferencat paraprake janë mbajtur në Beograd”.

Ne me këtë nuk jemi thelluar edhe aq në hulumtimet rreth këtij “Komiteti” apo “Lige” sepse ajo nuk është objekt studimi në këtë punim, por e kemi shënjuar sepse është ngushtë e lidhur me gazetën “Albania” si dhe të shihet se sa shumë çështje ka të pashtjelluara kur bëhet fjalë për marrëdhëniet shqiptare dhe serbe.

Gjatë asaj kohe në Beograd ka ekzistuar edhe një gazetë tjetër serbe-shqiptare, gazetë me titullin “Bratimstvo” (Vllaznija). Fatkeqësisht nga kjo gazetë nuk mund të gjendet asnjë ekzemplar. Në Bibliotekën Qendrore të ASHAS ka ekzistuar kjo gazetë, por që është zhdukur.⁴¹ Në numrin e lartcekur të gazetës “Albania” të datës 7. I. 1904 është

⁴¹ Për ekzistimin e kësaj liste, më ka informuar miku im Bozhidar Kovaçević, të cilit ngrohtësisht i falënderohem.

publikuar edhe një lajm i shkurtër, se në Beograd ka filluar të botohen edhe gazeta “Gazetat e Pallillullës” të cilën e boton zotëri z. Fortuna, vendas i yni, dhe shkruan për Gadishullin Ballkanik dhe për historinë e popullit shqiptar.

Pak më vonë, nga viti 1908 e deri në vitin 1920 në planin rreth bashkëpunimit ndër ballkanik ka vepruar edhe një personalitet mjaft interesant dhe kontradiktor, e ai është Dukagjin Zade Begu apo Basri Beg Dukagjini, siç e hasim emrin e tij në disa vepra të cilat i ka publikuar në gjuhën frënge.⁴² Aq sa unë kam informacione, nuk di që ka shkruar dikush për këtë personalitet, ndoshta për shkak të ideve të tija. Shkurtimisht do të paraqesim aktivitetin e tij politik dhe publicistik dhe të përqendrohemi në idetë e tija mjaft interesante që kanë të bëjnë pikërisht me temën tonë. Më 17 dhjetor të vitit 1908, Basri Begu ishte delegat i Dibrës në parlamentin e Turqisë. Mirëpo siç duket ishte zgjedhur në rrethana mjaft të dyshimta, sepse në Kongresin e mbajtur më 1909 në Dibër është kërkuar nga delegatët t’i merret mandati Basri Beg “Bulgaristanit”, të cilin e kishte dërguar mytesarifin i Dibrës si përfaqësues kundër dëshirës së popullit.⁴³ Basri Begu si anëtar i komitetit qendrori i partisë “Bashkim dhe përparim” ka marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit qendror në Manastir bashkë me Mit’hat Dhukri Begun, dr.Nazimin, Haxhi Adil Begun, më vonë ministër i Punëve të Brendshme dhe

⁴² Basribeg Be Dekagjini , *Le Mond eoriental e le prolème de la paix, Le présent à la lumière du passé*, Paris, Librairie Académique Perrin et C^{ie} 1919. Dukagjin Zade BASri bey, *L’Albanie independanteet l-Empire Khalifal aottoman*, Préface de Claude Ferréere, Paris, Librairie Académique Perrin et C^{ie} . Dukagjin Zade Bey *Le Mond eoriental et l’avenir de la paix*, Paris, Librairie Académique Perrin et C^{ie}, 120. Në faqe XXXVIII të pjesës së parë të kësaj vepre thekson se kjo është vepra e tij përkthim dhe tri veprave të tija të botuara në turqisht me titullin *Shqipëria dhe kriza osmane, Turqia e Re, Gjermania dhe oriento gjermanofon*, për të vazhduar më tutje: Il sera suivi d’un secon volume où, comme conclusion , seron formulé quelques jugement sociologiques sous le titre: *L’Avenir. Vers la dé balkanis Universelle*, Mirëpo, nuk kemi të dhëna se a thua janë botuar këto vepra në gjuhën turke.

⁴² Kenan Manastirli, *Debre Kongresi*, Istanbul, Cihan Matbasi 1828

⁴³ Kenan Manastirli, *Debre Kongresi*, Istanbul, Cihan Matbasi 1828.

me shumë të tjerë. Ai që atëherë bie në kundërshtim me udhëheqjen e xhonturqve. Në janar të vitit 1912 Basri Begu shkon në Kajro, me ftesë të kolegut të tij lordit Kiçener, të cilit më vonë ia kushton edhe një nga veprat e tija. Më 14 mars 1912 nga Egjipti kthehet në Stamboll, kurse më 15 mars nëpërmjet Selanikut dhe Manastirit kthehet në Dibër, sepse xhonturqit kishin tentuar të pengonin kandidaturën për delegat në përbërjen e dytë të Komitetit. Sipas fjalëve të tij, në Dibër është pritur në mënyrë triumfale dhe njëzëri është zgjedhur si kandidat. Mirëpo, meqë nuk pati zgjedhje, u kthye në Stamboll. Ai ndiqej nga xhonturqit, andaj nga nëntori i vitit 1913 e deri në prill të vitit 1914 u strehua në ambasadën e Holandës në Stamboll. Në fund të vitit 1915 arriti në Sofje. Sipas asaj që ai shënon, aty iu dha rasti të avancojë studimet e tija rreth “Bullgarisë antibalkanike”. Me hyrjen e Bullgarisë në luftë, Basri Begu, në janar të vitit 1916 arriti në Dibër dhe themeloi “kuvendin nacional”, kurse vetën e shpalli “kryetar të qeverisë kombëtare shqiptare dhe shef të pushtetit ekzekutiv.” Mirëpo, pikërisht tani mjeçullohet biografia e Basri Begut. Në disa burime shqiptare përmendet, se rreth asaj çështje ka biseduar me Jusuf Izedinin, i cili ishte kundërshtar i politikës gjermanofile të xhonturqve dhe se kishte protestuar kundër okupimit të Shqipërisë nga ana e Austro-Hungarisë etj. Hulumtuesit i paraqiten dilemat se a thua vërtetë Basri Begu ka qenë bullgar, apo i tillë është kualifikuar nga kundërshtarët e tij politik? Ai në veprat e tija, deklarohej si shqiptar, krenohet me origjinën e tij nga Dukagjini.⁴⁴ Ai aty flet për historinë e shqiptarëve, sidomos për historinë e dukagjinasve, jep të dhëna për disa lidhje familjare e shumë gjëra të tjera.

⁴⁴ Basri Begu në veprat e tij, përkundër asaj që nuk ka mendime të mira për shtet formimin e Shqipërisë, ai megjithatë lavdëron personalitetet shqiptare gjatë periudhës së Perandorisë Osmane. Ndër ato personalitete ai lavdëron teoricienin e njohur Koçi Begun, dëshmon se Quprillinjtë kanë origjinë shqiptare, Abaz Pashën, Hamza Pashën, Hasan Hamza Pashën, Osman Begun, Ali Pashën, Metali Begun, etj. Për një Ahmed Pash Kabashin, i cili ka qenë dijetar i madh i asaj kohe dhe ka lënë pas memoaret e veta ai thotë se ka qenë “frerë maternel de monpère”. E gjithë kjo na shpie që me rezervë të pranojmë tezën, se ai ka qenë me origjinë bullgare, ashtu siç është pranuar në historiografinë e popullit shqiptar.

Çfarëdo të kenë qenë makinacionet e pushtetit turk rreth zgjedhjes së tij për delegat në zgjedhjet e vitit 1908, vështirë është të besohet se ai nuk ka pasur njerëzit e tij nga radhët e bajraktarëve të Dibrës. Ai përmend një varg emrash të bajraktarëve të Dibrës, të cilët në vitin 1912 e kishin pranuar për delegat dhe ishin gati edhe me armë ta mbronin. Pastaj, sikur ai të ketë qenë bullgar apo agjent i Bullgarisë, atëherë pse pushteti i Austro-Hungarisë, në vitin 1916, e internoi në Jozefstadt dhe në Kőingsgrätz, dhe me shumë kujdes e përcillnin, për të cilët flasin dokumentet austriake? Sido që të ketë qenë, në vitin 1918 Basri Begun e liruan trupat franceze dhe ai transferohet në Paris. Nga atje ai me disa thirrje i drejtohet popullit shqiptarë që të mos ndërpresë lidhjet me Sulltanin, fuqive të mëdha u drejton disa memorandume në cilësinë e “Présidentu Gouvernement national albanais et Chef du Pouvoir Exécutiv ad internim 1915-1916”. Gjatë viteve 1919-1920 Basri Begu botoi disa vepra në frëngjisht rreth xhonturqve, rreth problemeve të Ballkanit, rreth problemeve të Perandorisë Osmane dhe kalifatit. Nga viti 1920 i humben çdo gjurmë.

Duke prezantuar këtë biografi të shkurtër të Basri Begut, duam të theksojmë se nuk kemi të bëjmë me një personalitet të thjeshtë, me një “bugar”, ashtu siç prezantohet në historiografinë shqiptare, por kemi të bëjmë me një njeri i cili ka luajtur një rol në revolucionin e xhonturqve dhe në parlamentin turk. Ka qenë tejet i shkolluar, shkëlqyeshëm e ka njohur literaturën franceze, e ka njohur gjermanishten, personalitet i cili ka mund të jetë aventurier i madh, mirëpo një person që ka qenë mik i lordit Kiçener, me të cilin ka pasur letërkëmbime, ka qenë mik i Pjerr Lotisë, kurse Klod Farer i ka shkruar parathënien e një vepre të tij. Mbi të gjitha në veprat e tij ka mjaft ide interesante rreth temës sonë.

Basri Begu edhe pse nuk e simpatizonte sulltan Hamidin duke e krahasuar me Heronin, ai me gjitha forcat luftonte për ta mbrojtur Perandorinë Osmane dhe hilafetin. Megjithatë, ai e kishte të qartë se Perandoria Osmane ishte në shpërbërje e sipër, andaj për ta ruajtur atë, duhet kërkuar forma tjera të qeverisjes në Ballkan. Në një fjalim, të

mbajtur në parlamentin turk, në vitin 1910, ai haptas kërkon revizione të politikës së jashtme turke, duke potencuar se marrëdhëniet me popujt e Ballkanit janë më me interes se me fuqitë e mëdha, sepse marrëdhëniet me fuqitë e mëdha varen nga marrëdhëniet me popujt e Ballkanit. Ai theksonte se “Turqia e re duhet të deklarohej si mbrojtës i vërtetë i një konfederate, e realizimi i saj do të ishte i vetmi shpëtimtar i Perandorisë. Para se gjithash duhet një njohje e mirëfilltë mes popujve të Ballkanit. Hap pas hapi duhet të ketë një konvencion interballkanik postar, më pas në një sistem monetar të përbashkët, për të vazhduar me një marrëveshje tregtare të mirë, e më pas duhet menduar për një union doganor.” Si binin ndesh interesat e fuqive të mëdha në Ballkan dhe në Lindjen e Mesme sipas Basri Begut, të interesat defensive të Anglisë dhe interesat agresive të Gjermanisë? Ai deklarohej kundër të dy fuqive duke kërkuar një federatë ballkanike. Fuqitë e mëdha viset ballkanike duhen t’ia linin popujve të Ballkanit dhe ata do të gjejnë gjuhë të përbashkët. Edhe atëherë kur ishin formuar shtetet ballkanike, pas marrëveshjes së Versajës, dhe atëherë kur Turqia përfundimisht ishte tërhequr nga Ballkani, Basri Begu prapë insistonte në një federatë Ballkanike. Ai shton: “duhet filluar me një federatë morale dhe defensive mes shteteve ballkanike për interesa ekonomike dhe morale të shteteve ballkanike.” Meqenëse nuk kanë pretendime territoriale karshi Turqisë, shtete ballkanike nuk kanë më arsye që të grinden me atë. Një mori interesa vitale i shpien të jenë bashkë me njëri-tjetrin. Mirëpo, për këtë bashkëpunim ballkanik, pengesa kryesore ka qenë Bullgaria, atëherë kur e mori fizionominë e Prusisë në Ballkan.⁴⁵ Në anën tjetër, Basri Begu shpresonte në rolin konstruktiv të Serbisë në federatën e ardhshme ballkanike, në të cilën, kuptohet fjalën kryesore do ta kishin turqit. Në këto shqyrtime ai në disa vende thirret në mikun e tij Fet’hi

⁴⁵ Mirëpo ne veprën e tij *Le Monde oriental et la avenir de la paix* ndër të tjera thotë: “E kaluara dhe përvoja na dëshmojnë se myslimanët e Ballkanit mund të jetojnë bashkë me rumunët (Dobruça), me serbët (Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina), bullgarët (në gjithë Bullgarinë), por kurrësi edhe me grekët. Kjo më së miri është parë në Thesali, ku e kaluara ka qenë vetëm e myslimanëve dhe e shqiptarëve, kurse sot elementi turk dhe shqiptar nuk ekziston fare.”

Pashën, të cilit ia kishte kushtuar një vepër të tërë. Ai atëkohë, kah viti 1905, ka qenë ambasador i Turqisë në Beograd, kurse në vitin 1911 ka qenë komandant i korpusit të III ushtarak në Manastir. Thuhet se Fet'hi Pasha ka bërë gjithçka që portet turke të jenë të hapura gjatë kohës së bllokadës austriake karshi Serbisë dhe se është angazhuar për një federatë mes Turqisë dhe Serbisë, në të cilën e shihte shpëtimin e Ballkanit. Do të ishte tejet me interes të analizohet vërtetësia e pohimeve të Basri Begut, se ai ishte i bindur për parinë e shqiptarëve të Dibrës gjatë tërheqjes së ushtrisë nëpër Dibër, se ka ndëshkuar disa pjesëtarë të bandave, të cilët kishin vrarë oficerë dhe ushtarë serbë të plagosur. Në konkluzionet përfundimtare të seancës së “asamblesë kombëtare”, të mbajtur në fund të janarit të vitit 1916 në Dibër, e që supozohet se ai e ka thirrur atë seancë, pika e parë thotë: “Shqipëria përkulet para tërheqjes heroike të popullatës dhe ushtrisë së Serbisë, e cila më shumë preferon të tërhiqet se sa të kapitultojë.” Ky qëndrim i tij rreth tërheqjes së ushtrisë serbe nëpërmes Shqipërisë, e kemi potencuar sepse na duket se Esat Pasha nuk ka qenë shqiptari i vetëm i cili e ka ndihmuar këtë tërheqje, por ka pasur raste të organizuara dhe individuale dhe veprime njerëzore duke u ofruar ndihmë refugjatëve serbë, por ja që kanë mbetur të pa hulumtuara, e në shumë “Përmendore” dhe në “golgotat shqiptare” janë harruar krejtësisht apo janë injoruar.

Këto ishin disa të dhëna lidhur me temën e sipërpërmendur, të cilën në hulumtimet e ardhshme, me siguri më në detaje do t'i shqyrtojmë dhe me detaje të reja do ta begatojmë. Duke marrë këtë temë për objekt studimi në këtë kumtesë, janë tema gati të paprekura. Qëllimi jonë ka qenë të parashtrijmë disa probleme dhe të hapim shtigje të reja për hulumtime të mëtutjeshme lidhur me këtë temë. Duke u nisur nga fakti se obligim i gjithë neve është t'i studiojmë dhe t'i ndriçojmë sa më mirë disa procese dhe ngjarje nga e kaluara e popujve tanë që kanë rezultuar me afrimin dhe njohjen sa më të mirë mes vete.

Përktheu:

Dr. Isa Memishi